




Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca : 626-24-4320-2-2-1

Me 28.06.2024
Në Mamushë

Në bazë të nenit 108/A paragrafi 6 dhe paragrafi 8 pika 8.3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe në bazë të Rregullores 001/2022 Për prokurimin Publik neni 60 paragrafi 60.1 dhe 60.3, si dhe nenit 61 paragrafi 61.2 dhe 61.3 pas dërgimit të shkresës Operatorit Ekonomik "Zeqir M Krasniqi" B.I. për plotësimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues-Komuna e Mamushës për procedurën e prokurimit me nr. të prokurimit 626-24-4320-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-24-006-2-2-1, bie këtë:

V E N D I M

I

Refuzohet si e **pa plotë** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik "Zeqir M Krasniqi" B.I. e parashtruar me datën 24.06.2024 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-24-4320-2-2-1 nr. të brendshëm 626-24-006-2-2-1 dhe titull "**SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS-RITENDER**

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik Zeqir M Krasniqi" B.I. me datë 24.06.2024 nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit pranë Autoritetit Kontraktues Komuna e Mamushës.

Si Autoritet Kontraktues, në afatin ligjor kemi filluar shqyrtimin e kërkesës, mirëpo gjatë shqyrtimit, kemi vërejtur se kërkesa për rishqyrtim nuk është paraqitur në përshtatje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik në Kosovë, përkatësisht në nenin 108/A paragrafi 4 të "LPP"-s dhe nenin 60 paragrafi 60.3 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 për arsyet e cekura më poshtë:

Në nenin 108/A paragrafi 4. lidhur me nenin 111 paragrafi 1 është paraparë: Aplikimet për rishqyrtim duhet të paraqiten me shkrim dhe duhet të përmbajnë të njëjtin informacion dhe

dokumente të përcaktuara në nenin 111 paragrafi 1 të këtij ligji, me përjashtim të nën-paragrafit 1.9 dhe 1.10.

Në kërkesën për rishqyrtim të vendimit të paraqitur nga O.E. ankues mungojnë shumica e elementeve të kërkuara në dispozitat ligjore të cekura më lartë të cilat po i listojmë në vijim:

1. Mungon emri dhe informatat e kontaktit të parashtruesit të ankesës;
2. Kërkesa për rishqyrtim nuk përmban një përshkrimin specifik të arsyeshem të aktiviteteve përkatëse të prokurimit;
3. Me kërkesën për rishqyrtim O.E. me asnjë fakt, provë apo rrethanë nuk ka demonstruar se si parashtrues i ankesës kualifikohet si “palë e interesuar” siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji pasi që keni dorëzuar tender të pa përgjegjshëm si dhe keni dorëzuar tenderin me çmimin më të lartë në mesin e tenderuesve pjesëmarrës në këtë tender;
4. Në kërkesën për rishqyrtim nuk ka përshkruar rrethanat faktike që përbëjnë ose që ngritin supozimin për shkeljen e këtij ligji; dhe
5. Nuk ka përshkruar mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës në raste kur ankuesi përfshin pretendimin për kompensim.

Në bazë të nenit **108/A paragrafi 4 të “LPP”-s dhe nenin 60 paragrafi 60.3 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022** me datë 25.06.2024 nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik me kërkesë për plotësimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, kemi kërkuar nga O.E. ankues që të plotësojnë kërkesën e tyre për rishqyrtim dhe të njëjtën ta paraqesin nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik brenda dy dite përkatësisht deri me datën **27.06.2024** në ora **13:00** me paralajmërim që ***në rast se O.E. nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur dhe nuk e plotëson kërkesën e tij kërkesa do të refuzohet si e paplotë.***

Operatori Ekonomik nuk i është përgjigjur kërkesës tonë dhe nuk e ka plotësuar kërkesën për rishqyrtim brenda afatit ligjor.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë si dhe në dispozitat në fuqi të Legjislacionit të Prokurimit Publik u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi
Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
në Komunën e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues.